

V E N D I M
Nr.514, datë 31.10.1994

**PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË PËRFAQËSUESIT TË AUTORIZUAR TË
PATENTAVE**

Në mbështetje të ligjit nr.7815, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”, ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit”, ndryshuar me ligjin nr.7723, datë 21.6.1993 “Për një shtesë në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991”, me propozimin e Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1.Zyra e patentave pranë Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë lëshon leje për ushtrimin e profesionit të përfaqësuesit të autorizuar të patentave.

2. Personat fizikë e juridikë dhe personat fizikë të punësuar e të autorizuar nga personat juridikë, të pajisur me lejen për ushtrimin e profesionit të përfaqësuesit të autorizuar të patentave sipas pikës 1 të këtij vendimi, regjistrohen në gjykatë dhe organet tatimore sipas dispozitave në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi